

INFORMACION PER FAQEN E INTERNETIT TE BKT-se BAZUAR MBI PARIMET E UDHËHEQJES SE KORPORATES

Përditësuar më 31 dhjetor 2023

1.POLITIKA E SHPËRNDARJES SË FITIMIT

Mekanizmi i vendimmarrjes per shpërndarjen e fitimit tek Banka Kombëtare Tregtare ("BKT" ose "Banka") përbëhet nga rekomandimi i bere nga Keshilli Drejtues dhe miratimi i marrë nga Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve.

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve në BKT mbahet të paktën një herë në vit, duke synuar që të miratojë pasqyrat financiare të Bankës dhe të vendosë për shpërndarjen e fitimit te vitit te fundit financiar të mbyllur.

Bazuar në vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve, të gjitha fitimet e realizuara nga BKT gjatë viteve financiare 2000-2015 janë kapitalizuar dhe janë përdorur nga Banka për të mbeshtetur zmadhimin e vazhdueshëm të bilancit dhe për të rritur fitimin.

Më 30 mars 2017 Banka realizoi shpërndarjen e parë të dividendit tek Aksioneri i saj.

Mbledhja e Përgjithshme datë 30 mars 2023, miratoi rezolutën Nr. 2 si më poshtë:

"Miratohen pasqyrat financiare statutore dhe SNRF të audituara nga "Grant Thornton" sh.p.k., për vitin financiar mbyllur më 31 dhjetor 2022".

Që sipas rekomandimit të Këshillit Drejtues, fitimi neto i BKT Shqipëri për vitin 2022; 8,151,720,473 Lekë të përdoret si më poshtë:

- a) Një pjesë e fitimit neto: 407,586,024 Lekë do të përdoret si rezervë ligjore bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- b) Vlera e akumuluar nga fitimi i pashpërndarë i vitit 2021 në shumën 3,830,997,299 Lekë dhe pjesë e fitimit neto të vitit 2022 në shumën 1,385,502,701 Lekë, në total 5,216,500,000 Lekë ekuivalent në 50,000,000 USD, sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e sotme, USD 1.00 = Lekë 104.33, do të përdoret për tu shpërndarë si dividend tek ÇALIK HOLDING ANONIM SIRKETI, si aksioner i vetëm i BKT. Kjo shumë do të paguhet me datë valutë 4 Maj 2023.
- c) Pjesa e mbetur e fitimit neto: 6,358,631,748 Lekë do të mbahet si fitim i pashpërndarë.

Në rezolutën nr. 4 "MAZARS" sh.p.k. emërohet si auditor i jashtëm i Bankës (Ekspert Kontabël i Autorizuar) për vitin financiar që përfundon më 31 dhjetor 2023.